

## INTERVISTË ME LULJETA MYFTARI BAJRIN

Pejë | Data: 7 shkurt, 2015

Kohëzgjatja: 127 minuta

Të pranishëm:

- Luljeta Myftari Bajri (E intervistuar)
- Lura Limani (Intervistuesja)
- Donjeta Berisha (Kamera)

*Simbolet e komenteve në transkriptë te komunikimi jo-verbal:*

*() - komunikim emocional*

*{ } - e intervistuar shpjegon me gjeste*

*Simbole të tjera në transkriptë:*

*[ ] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin*

*Fusnotat janë shtesa editoriale të japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje*

## Fëmijëria

*[Pjesë e prerë nga video-intervista: intervistesja kërkon nga e intervistuar ta prezantoj vetën dhe të flasë rreth fëmijërisë së saj.]*

**Luljeta Myftari Bajri:** Unë jam Luljeta Bajri, jam lindur në Pejë në si me thonë, në flakën e luftës në vitin 1943 nga babai im Emrush Myftari dhe nëna Hajrie Mekuli Myftari. Të flas për fëmiminë time ndoshta osht' pak e dhimbshme, por sidoqoftë njerëzit kalojnë nëpër shumë peripeti të jetës. Ne e kem pasë fatin, unë dhe vllavi im Kujtimi, që qysh në moshë të re të mbesim pa prindë. Meqë babain tim, në vitin... dikun kah fundi i vitit '44, ose në fillim të vitit '45 e kanë ekzekutu, e kanë pushkatu dhe atë në Prishtinë në vendin që quhet Strelishte, tash diku te Taukbahçja. Dhe në atë vend natyrisht se kanë pushkatu edhe shumë njerëz tjerë, patriotë, personalitete të ndryshme dhe sot e kësaj dite ai ka ngelur pa varr.

Të flas për historinë e familjes sime, kam shumëçka të thom, edhe pse, ato i kam ndi prej tjerëve. Mas vdekjes së babait, unë kam qenë dikun një vjet e diçka kur ka vdekë babai, e ndërsa nana ime ka qenë shtatëzanë dhe mbas katër-pesë muajve, mbas pushkatimit të babait, ajo ka lindë djalë, vllaun tim Kujtimin i cili si emën ka qenë i lanun amanet prej babait tim që me ia vu emnin Kujtim, se e ka pa se rrjedhat si po shkojnë edhe e ka pritë që diçka ka me ngja me te.

Kisha me folë pak edhe për historinë e babait tim. Babai im ka qenë vllau i tretë ma i vogli, ka pasë edhe dy vllazën tjerë Sherifin dhe Xheladinin të mesmin, edhe Emrushin babai im. Axha ma i madh Sherifi ka qenë një njeri me ide shumë përparimtare. Më duket atëherë ka qenë i përfshimë në lëvizjet që kanë qenë për demokratizim ma... ato kanë qenë do lëvizje të përbashkëta domethonë, edhe serbe edhe shqiptare për demokratizimin e shoqërisë. Ai ka pasë dëshirë që baba im të vazhdojë shkollimin dhe e ka dërgu... domethonë njëherë e ka kry shkollën fillore.

Fillimisht nuk ka dashtë fort, nuk ka qenë fort për shkollë, nuk ka qenë fort i nxehtë, mirëpo e ka pasë një mik të vetin, profesor në gjimnazin e Pejës, serb. Një profesor i vjetër, i cili po ashtu ka qenë me ide

shumë përparimtare për barazinë kombëtare, për ato krejt... edhe e ka vërejtë se Emrushu ka një intelegjencë natyrale dhe i ka thonë, iu ka drejtu axhës tim i thotë, “Çka po don ky djalë?” “S’po don me shku në shkollë, s’di çka me bo. Une p’e angazhoj me punu rreth shpisë e rreth punëve e ktyne tjera...” Thotë, “A ma jep mu ta përgatisë?” Edhe ky e përgatitë, e sheh mandej regjistrohet e kryjnë, domethonë mas shkollës fillore shkon në gjimnaz, në gjimnaz dallohet si nxanës shumë i mirë. Bile në hartimet që i bon, ia përcjellin prej klasës në klasë t’u i lexu edhe t’u i thonë... se atëherë shkolla ka qenë në gjuhën serbo-kroate.

Mbasi e kryjnë gjimnazin ai i propozon me shku në Beograd ky profesori edhe konkurren me një shok të vetin Veli Dedi, i cili ka qenë nga Medvegja. Në Beograd nuk i pranojnë, domethonë i kthejnë edhe kthehet baba shumë i demoralizim me gjithë atë shokun e vet. Natyrisht se edhe mixha im, i vjen randë për atë çka ka ngja dhe e përgatitë terrenin që ilegalisht me i qitë në Shqipëri. Domethonë, kalojnë Emrushu edhe Veli Dedi, kalojnë në Shqipëri. Në Shqipëri edhe disa pejanë të tjerë kanë shku, Shaban Basha më duket, Xhemajl Kada dhe këta kanë shku ma herët. Edhe ata orientohen kah me shku nëpër shkolla. Veli Dedi edhe baba im shkojnë në Liceun e Korçës, ndërsa Shaban Basha me Xhemajl Kadën shkojnë në Torino me kry shkollën ushtarake atje.

Natyrisht se në Korçë, në Liceun francez të Korçës, aty takohet me shumë personalitete të kohës, dhe sa më kanë tregu edhe shokët e babës, ai ka qenë në një gjeneratë me Enver Hoxhën. Domethonë, jonë njoftë prej Liceut të Korçës. Mbasi e kryen Liceun e Korçës, atëhere kjo osht’ koha, perioda e Mbretit Zog atëhere domethonë në Shqipëri. Meqë e kishte nevojë për kuadër ushtarak, atëhere ky me gjithë Veli Dedin shkojnë në shkollën ushtarake, domethonë si lloj akademie ushtarake në kohën e Zogut edhe e kryjnë me sukses. Mirëpo, situata në Shqipëri natyrisht që nuk ka qenë aq e mirë sa duhet. Këta kanë qenë me ide ma progresiste, kanë qenë ma të hapun.

Edhe në atë kohë, domethonë viti 1937, shpërthen lufta në Spanjë. Atëhere baba im, Veli Dedi, Xhemajl Kada, Shaban Basha shkojnë si vullnetarë në luftën e Spanjës edhe Justina Shkupi, një motër medicinale e cila po ashtu e kishte kry një shkollë speciale, më duket në Itali ose në Francë, nuk e di dhe ka qenë shoqe me Nanë Terezën, bashkë e kanë kry shkollën medicinale. Lajmrohet edhe ajo si vullnetare me shku, ajo ka qenë kosovare domethonë edhe kjo. Në Luftën e Spanjës kanë shku edhe prej Shqipërisë edhe prej Maqedonisë, më duket edhe prej Malit të Zi. Domethonë, aty jonë mbledhë, si me thonë ajka intelektuale shqiptare, prej të gjitha trojeve shqiptare.

Mirëpo, kta kanë qenë të organizim në Batalionin Garibaldi i cili ka pasë si sekretar ose si udhëheqës të atij Batalioni Luigji Longun, një personalitet të njoftun italian, i cili mandej edhe mbas shpërthimit ka qenë kryetar i Partisë Komuniste italiane më duket, nëse s’gabo. Edhe aty kanë pasë kontakte, domethonë meqë kanë qenë në kuadër e Batalionit Garibaldi. Aty jonë njoftë edhe me shumë njerëz nga krejt Evropa që kanë ardhë. Për shembull, aty kanë qenë edhe shkrimtarët e njoftun si Orvelli, mandej ka qenë Hemingvej, kanë qenë edhe shumë personalitete tjera të kulturës, të artit, shkrimtarë. Edhe aty kanë pasë më duket edhe kontakte mes veti të mdhaja.

Çdo grup i ktyne vullnetarëve ka pasë, se ka botu edhe revistën, revistën e vetme në gjuhën, natyrisht

anglezët në gjuhën angleze, italianët në gjuhën italiane. Shqiptarët si një grup ma i vogël... edhe pse një studiuese e cila e ka studiu... spanjolle, nuk po më kujtohet, Suarez më duket emnin. Nuk po më kujtohet mbiemni veç, s'po më kujtohet emni. Ajo e ka studiu këtë grupin e vullnetarëve shqiptarë në Spanjë, edhe ka thonë se, meqenëse edhe proporcionalisht prej numrit të popullsisë ata kanë qenë një grup jo i vogël. Dhe, çka osht' për t'u cekur, të gjithë kanë qenë me përvojë ushtarake. Shumica kanë qenë me akademi ose shkolla të larta ushtarake. Domethonë, kanë qenë njerëz të përgatitun.

Baba im ka qenë oficer i artilerisë dhe ato sa më ka spjegu, aty prej Shqipërisë ka qenë edhe shkrimtari Petro Marko, aty domethonë kanë kriju marrëdhënie shoqërore shumë të mira. Petro Marko ka qenë i moshës ma të re edhe për ta mbrojtur... edhe ka pasë talent për shkrime. Atëhere baba nuk e len kto me shku në front, e çon te italianët, e prezenton e thotë, "Ky osht' shkrimtar edhe gazetar i mirë. Osht' shumë ma me interes ky me raportu edhe me shkru për çka po ngjet," domethonë me luftën në front, "sesa me shku edhe me u vra në luftë".

Shkojnë një grup prej 15 vetëve nga shkolla fillore "8 Marsi" në vizitë të shkollave të Shqipërisë. Unë nuk di prej nga kishte marrë vesh se kemi me shku. Edhe kur kem shku në Durrës, në një hotel aty... në korridor më ka thirrë, aty ku ishim në grup, më thërret një njeri. Më thërret edhe më thotë, "Po të presim, në atë sallën tjetër. Po të pret Petro Marko edhe Justina Shkupi". Justina Shkupi tash ju tregova edhe ma heret se ka qenë në Luftën e Spanjës edhe ajo përmendet në romanin "Hasta la Vista" si infermierja Drita. Edhe, kur më kanë pa (buzëqeshë), kanë qenë emocionet edhe tynet edhe të mijat, kanë qenë shumë të fuqishme.

Kanë fillu te dytë mme më përqaftu edhe me na shku lotë edhe atyne edhe mu. Tha, "Po na vjen shumë mirë që me u taku me vajzën e Emrushit", edhe aty kem fillu mandej me evokimin e kujtimeve prej Luftës së Spanjës e prej... mandej më kanë marrë edhe në shtëpi, aty kanë thirrë edhe kta disa luftarë të Spanjës. Më kanë çu në shpinë e një luftarit të Spanjës, Ramiz Varvarica, i cili ishte martu me një spanjolle, edhe kishte marrë grunë në Shipni te ajo... domethonë, kanë qenë emocione shumë të fuqishme, edhe nga ana ime se shihesha për herë të parë. Babën s'e kisha njoftë fare e tash shihesha me shokët e babës.

**Lura Limani:** Çka tjetër ju kanë tregu për babën gjatë luftës?

**Luljeta Myftari Bajri:** Urdhno?

**Lura Limani:** Çka tjetër ju kanë tregu për babën gjatë luftës?

**Luljeta Myftari Bajri:** Gjatë luftës baba im ka qenë domethonë me ide të majta. Me ide të majta ka qenë për ate që populli shqiptar prej Luftës së Dytë Botërore të dalë si popull i barabartë me gjithë popujt tjerë të ish- Jugosllavisë, të Jugosllavisë... nejtë. Ka qenë në... kur osht' majtë Mledhja e Bujanit, ata kanë fillu veç tu i pa idetë e tij, natyrisht se ktu ndikimi ka qenë edhe i ktyne komunistave serbë edhe malazezë të cilët jonë njoftë qysh prej Luftës së Spanjës edhe ata gjithnjë jonë mundu atje shqiptarët me i lonë në plan të dytë, domethonë me i injoru krejt. Baba shumë ka, në atë drejtim, ka

pasë konfrontime qysh në Spanjë me komunistat serbë edhe malazezë. Edhe kur osht' kthy mandej, kur jonë kthy prej Spanjës... aha prej kur ka kapitullu domethonë lufta e Spanjës, ata kanë kalu në Francë.

Në Francë jonë tubu domethonë të gjithë aty. Në Francë ka pasë studenta shqiptarë shumë që kanë studiu atje. Mandej ka qenë edhe ky Ali Kelmendi si anëtar i Kominterit më duket, Lëvizja Komuniste. Edhe në Francë jonë taku mandej dhe me Zeqeria Rexha, po ashtu intelektual i shquar shqiptar, ka studiu në Francë në Lion. Atëhere takohen në Paris dhe vendosin me e botu një gazetë në gjuhën shqipe, gazeta quhet "Sazani". Po më vjen shumë keq se i kom pasë edhe ato gazeta këtu, po gjatë luftës kur o djegë shpija, me shpi jonë djegë edhe shumë materiale. Kem arritë diçka me shpëtu, shumë pak.

Edhe mandej prej Francës, Zogu nuk i pranon me u kthy në Shipni, meqë kanë qenë me ide komuniste. Atëhere baba shkon në Turqi, shkon në Palestinë, shkon në kto shtetet e Lindjes. Domethonë, në Turqi fillon propagandën kundër shpërnguljes së serbëve... qy serbëve (buzëqeshë), më fal... kundër shpërnguljes së shqiptarëve në Turqi. Prej Turqisë kthehet mandena edhe natyrisht se kyçet në Lëvizjen Komuniste këtu në Pejë. Mirëpo, gjithnji edhe e kanë respektu si kuadër i përgatitun, si kuadër i shkollum, si njeri i cili i ka ditë pesë-gjashtë gjuhë të huja. Mirëpo, edhe ia kanë pasë gjithënji frigën, se ai prej fillimit i ka tregu idetë e veta se shqiptarët duhën me dalë prej kësaj lufte si komb në veti, me pas të drejtat si gjithë popujt tjerë. Ajo natyrisht, se disave nuk iu ka pëlqy.

Kështu që, në një kohë ai pak edhe tërheket prej lëvizjes edhe e hapë librarinë e parë në Pejë. Libraria quhej "Libraria Skënderbej – Vllazën Myftari". Mirëpo, fillimisht ai e udhëheqë librarinë e ma vonë detyrohet me kalu edhe në ilegalitet, se gjithënji italianët e përndjekin, mandej e burgosin, ka qenë në burgun e Tiranës. Atëhere i thotë, në librari punon axha im Xheladini edhe e merr edhe nanën time me punu në librari.

Baba im kur kthehet prej Spanjës, prej Spanjës e prej Francës e knej, meqë në luftën e Spanjës vritet Xhemajl Kada edhe vritet Asim Vokshi dy shokë të ngushtë të babës. Ai ato çka kanë mbetë, domethonë kujtimet e teshat e Xhemajl Kadës, i bjen në familjen e Xhemajl Kadës domethonë te Rexhë Kada. Gruja e Rexhë Kadës ka qenë tezja ime, Sheqere Kada. Edhe aty, nejse vijnë mandej ngushllimet për vrasjen e Xhemajlit, edhe ai ka qenë oficer me grada të nalta i ka kry në Itali. Edhe baba ka qenë shumë i indinjum dhe atje në Spanjë ka pasë edhe konflikte edhe me kta udhëheqësit e Garibaldit se thotë, "Ju neve shqiptarëve gjithmonë po na qitni në vijat e para të luftës, ndërsa të jujt po i runi".

Edhe thotë, "Aty na vriten dy oficerë të mirë, dy ushtarakë të mirë të cilët kanë mujtë me udhëheqë e jo me qenë në vijat e para të luftës". Atëhere e pytë babën tem, i thotë, "Emrush, çka don tash ti me bo? Duhesh me krijë familje." "Nuk muj se une jom me... se po merrna me politikë, me ide, nuk du me marrë në qafë asnji vajzë të re. Edhe, nuk ka të shkollume që mujnë me më kuptu. Nuk du me i marrë në qafë". "Jo," thotë "unë ta gjoj një vajzë. Osht' kjo balldëskja ime [motra e bashkëshortes], Hajria – çika e Hoxhë Nokshiqit në Plavë, e cila e ka kry Shkollën Mbretënore në Beograd, Shkollën Mbretënore

për amvise në Beograd”.

Tash do të ju tregoj pak historinë, se gjyshi me gjyshen më kanë jetu’ deri vonë. Domethonë, unë kom qenë 14 vjeçare kur më ka vdekë gjyshi, mandej ma vonë më ka vdekë gjyshja. Edhe, ne çdo pushim kur e kishim, axha na çojke në Plavë mu edhe vllaun. Meqë nuk kishte shumë komunikacion kah gryka e Rugovës, atëherë e porostike një njeri me një kali, edhe dy kosha anash. Gruja e axhës na përgatitke një asi edhe unë një kosh, një kosh vllau dhe shkojshim kah Qafa e Dillit. Në Qafë të Dillit, axha na ndalke gjithë, ka qenë një burim I ujit, me pi me hongër diçka dhe me pushu. Edhe, na tregojke, kanë qenë katër varre aty. Tregojke, thojke, “Janë katër varre, njëni prej varreve osht’ i vllaut tim Sherifit, i cili ka shku si vullnetar me luftu në kufinin malazez, për mos me hy ushtria malazeze, për mos me hy në Kosovë, edhe aty bjen si dëshmor”. Domethonë, sot edhe kësaj dite vorri osht’ atje.

Nejse, tash po ju tregoj për nanën time. Nana ime e kryënë atë Shkollën Mbretërore. Mbreti, domethonë Aleksandri atëhere i ish-Jugosllavisë e çon një shkresë në Plavë. Gjyshi im ka qenë imam në xhaminë kryesore aty të Plavës, ku thotë se një vajzë prej Plavës e Gusicës mundet me ardhë, mund ta dërgoni në Shkollën e Amviseve në Beograd. Edhe ajo paraqitet para xhematit. Mirëpo, kërkush nuk pranoi, thanë, “Jo, nuk i çojmë vajzat atje me u ba...” domethonë qysh e kanë përdorë atëhere (buzëqeshë), “me u ba shkina”. Edhe gjyshi thotë, “Mirë, unë e kom pasë obligim me paraqitë këte, unë e çoj vajzën time.” Edhe e çon nanën time. Kjo ka qenë motra e katërt me rradhë. Pasi e kryënë atë Shkollën e Amviseve me një sukses shumë të mirë, më vjen keq që nuk e kom, ia kanë dhonë edhe ate stemën e kunorës, ajo si kunorë ashtu e punume, e prarume me ari, plus edhe diplomën. Jonë kallë edhe ato krejt.

Kthehet në Plavë edhe ajo domethonë i mledhë, bohet si një, i mledhë krejt vajzat e Plavës, iu jep këshilla për përgatitjen e ushqimit, si duhet me i rritë fëmijtë, për... si duhet me i rritë foshnjët, si duhet... i mëson punëdore, krejt ato përvojat që i ka marrë në atë shkollën e Beogradit. Edhe, kur i propozon Rexhë Kada për këte, atëhere takohen me... vjen ajo ktu në Pejë, nana ime. Takohet me babën, fejohen edhe mbas një kohe martohen. Ka qenë martesë e babës tim pak si njëfarë senzacioni në Pejë, se osht’ hera e parë që vjen ni nuse në Pejë me vella të bardha. Plus, shkon baba me marrë me mobilin e vet privat që e ka pasë. Këtu kanë qenë edhe fotografijat, jonë kallë krejt. Edhe, gjyshi im e përgatitë një përcjellje shumë të mirë edhe dinjitoze, thërret musafirë shumë edhe vjen nana ime ktu në Pejë me jetu mandej.

Natyrisht, se menihere fillojnë peripetitë, burgosjet e babës. Për katër vjet sa kanë jetu bashkë, ma shumë nuk ka qenë te shpija se ka qenë. Kohë mbas kohe ka ardhë, nëpër burgje nëpër andej. Edhe, kur e pushkatojnë babën, nana mbetet domethonë me mu si fmi, edhe lindë mandej edhe vllau. Ktu basitset shpija edhe e qesin me pushkatu axhën tim ktu në kopsht. Meqë e kërkujshin një radiostacion, duheshin me gjetë pretekst pse ishte pushkatu. Edhe ka qenë, preteksti për pushkatim ka qenë se ka qenë anëtar i *Intelligence Service*-it, mbasi e ka ditë gjuhën angleze. Plus, e kishte pasë edhe një mike angleze njëfarë Flavia Kingston po më duket, që ka jetu në Zagreb edhe ka ardhë, ka qenë edhe këtu te na në Pejë disa herë ktu në familjen tonë. Domethonë edhe e konfiskojnë pasuninë e babës.

Baba meqë e ka pa situata kah po shkon, ka pasë bibliotekë shumë të pasun me libra jo vetëm në

gjuhën shqipe, po edhe në gjuhë tjera. Meqë ka qenë në Itali, ka shëtitë nëpër Evropë domethonë. Tu e pa situatën çfare osht', krejt bibliotekën e murrën në ato isbet e vjetra që kanë qenë në shpinë e babës aty edhe e ve një mur... plus edhe materialet që kanë qenë të librarisë. Natyrisht se krejt aty nuk ishin, mbesin edhe shumë libra edhe jashtë. Diçka që më ka mbetë prej fëminisë time, ka pasë prej të gjitha qendrave në Evropë ku janë botu revistat shqipe, i kem pasë ktu. Kem pasë revistën "Vatra", revistën "Dielli", revistën "Flamuri i Arbërit". Nuk po më kujtohen edhe tash, veç në qendrën domethonë në Amerikë, Faik Konica ku ka vepru me gjithë Fan Nolin edhe ato revista.

Fatkeqësisht, meqë kem qenë gjithnjë në mbikqyrjen e Shërbimit Sekret, domethonë si familje, dikush që ka qenë prezent kur asht' ba murimi, kur jonë hi ato librat, ka lajmru. Meqenëse nuk kanë gjetë, atëhere krejt kopshtin e kanë groposë gjoja me lypë radiostacionin. E kanë qitë axhën me u pushkatu, nana ime ka shku i ka thonë, "Unë jam gruaja e Emrushit. Ne e kem këte të vetmin mashkull te shpija, nëse duhet m'u pushkatu, pushkatomni mu". Nejse, radiostacion nuk gjejnë kurgjo edhe atëhere e rrëzojnë murin, kanë bajtë me qerre dy-tri ditë. Natyrisht qysh më ka tregu axha, se unë kom qenë atëhere e vogël, dy vjeçe e gjysë. E marrin krejt bibliotekën me libra me makina të shkrimit, me material çka ka pasë aty edhe shkojnë. Nanës time mandej i keqësohet gjendja shëndetësore edhe meqenëse gjithnji nën mbikqyrjen përcjelljen prej familjes, ia bjen domethonë... kem qenë si familje e anatemume pak. Jo prej popullit, në popull kem pasë autoritet shumë të madh, të gjithë na kanë respektu.

Bile, më kujtohet ka qenë një profesor i gjimnazit të Pejës, shok me babën, Mikel Marku. Një profesor i cili ka dhonë gjuhën serbo-kroate në gjimnazin për paralelet shqipe. Edhe në çdo 28 nandor ai vijke me na vizitu neve dhe na bijke libra, na bijke fletore, lapsa. I thojke axhës, "Xhelë, Emrushit të gjithëve na ka përkrahë, na ka dhonë libra, na ka dhonë materiale, s'ka kqyrë. Na ka dhonë krejt çka kem dashtë prej librarisë, na duhem me u kujdesë për fëmitë e Emrushit pasi kanë mbetë pa prindë". Nana ime, i propozon mjeku me shku në Plavë masi iu ka keqësu gjendja shumë, edhe shkon në Plavë me ne dytë.

**Lura Limani:** Në cilat vite?

**Luljeta Myftari Bajri:** Urdhno?

**Lura Limani:** Në cilat vite?

**Luljeta Myftari Bajri:** Vitet '44. Fundi i '44-shit, domethonë mas pushkatimit të babës, ose fillimi i '45-tës ashtu. Shkon në Plavë te prindtë e vet edhe atje kujdesen natyrisht nana e vet, motrat e veta. Në vitin '46, plus aty kujdesen edhe dy mjekë hungarezë të cilët kanë qenë miqtë e gjyshit tim, që kanë ardhë gjatë Luftës të Dytë Botnore dhe iu ka pëlqy shumë Plava si vend piktoresk me liqenin e ato. Nuk jonë kthi në Hungari, kanë mbetë në Plavë aty si mjekë. Edhe ata vazhdimisht kanë ardhë me u kujdesë për nanën.

Une dy vjet e gjysë, diçka ma tepër, na vdes nana. Na vdes nana dhe ne mbesim në Plavë te gjyshi e

gjyshja. Aty e kem pasë edhe një teze vajzë, tezen Fatime e cila vendosë mos me u martu, vetëm me na rritë neve. Mirëpo, ktu në familjem time të axhës domethonë mbeten disa vdekje, domethonë pushkatohet... vdes në frontin e luftës axha Sherifi, vdes nana ime, pushkatohet baba, domethonë familja mbetet vetëm me axhën, edhe dy gratë e axhës, asaj që i vritet burri atje edhe... atëhere axha im vjen në Plavë me na marrë neve. Gjyshja me tezen nuk dojnë me ndi me na lshu. Kush me na kqyrë? Mendojnë se kanë me na kqyrë ma mirë atje në Plavë.

Mirëpo, axha ia hekë kapelën gjyshit edhe i thotë, “Të lutem, na kemi qaq tragjedi të randa kem përjetu, barëm fëmijtë, ama njerin prej fëmive”. Edhe shkon i thotë, “Une nuk muj me u kthy pa njërin, pa një fëmi”. “Ani,” thotë, “cilin po don Xhelë me marrë?” Thotë, “Valla, une p’e marrë vajzën”. Edhe më merr, axha më merr mu, më bjen ktu në Pejë. Mirëpo, tanë kohën as une nuk jom këtu e qetë, edhe pse e vogël, se po e lypi vllaun (buzëqeshë). Edhe vllau andena... jem msu bashkë me qenë. Atëhere e merr gjyshi, mbas një kohe e merr edhe vllaun e bjen, domethonë na rritemi te axha.

Axha ka pasë edhe gruja e axhës kanë pasë kujdes maksimal, nuk kanë pasë fëmi. Domethonë edhe atyne iu ka plotësu një dëshirë, që na kanë pasë fëmi neve. Axha ka bo çmos që na me pasë fëmininë sa ma të lumtun, sa ma të bukur. Na i ka plotësu të gjitha kushtet, kem vazhdu shkollën, domethonë ka qenë, unë bile në momente mendoj se nuk kom bo për fëmijtë e mi, qaq sa ka bo axha edhe gruja e axhës për ne. Axha ka qenë një njeri shumë i mençëm, i hapun. Mu nuk më ka ndalë, për qe kanë qenë vitet, natyrisht vitet kur vajzat nuk jonë lonë bash për me shku në aktivitetet shkollore e ato, mu s’më kanë ndalë kurrë. Domethonë, çdo aktivitet që osht’ bo në shkollë, korin e shkollës, orkestrën e shkollës, ekskurzionet e shkollës, tona ato sletet që kanë qenë në atë kohë, mu kurrë nuk më kanë ndalë. Në një mënyrë, në krah temin mandej kanë fillu edhe shoqet e mija, meqë axha ka pasë autoritet këtu në rrethin ku ka jetu edhe ku ka...

## Rinia

*[Pjesë e prerë nga video-intervista: intervistuesja kërkon nga e intervistuarja të flasë për rininë e saj.]*

**Luljeta Myftari Bajri:** Shkollën fillore, e kam kry në Pejë, atëhere jonë ndrru... kom qenë njihere në shkollën në Karagaq atëhere quhej “Miladin Popoviç”, mandej u ndërta shkolla “Ramiz Sadiku”, ktu shkollë e re, kem kalu ktu. Kom kalu shumë mirë, i kom pasë shoqet shumë të mira. Kem bo shumë aktivitete, aktivitete të lira, kori i shkollës, shëtitjet e ndryshme, mbas asej kom vazhdu në gjimnazin e Pejës. Domethonë, në gjimnazin e Pejës ka qenë viti ‘56- ‘57, vitin e parë. Atëhere kemi qenë veç dy paralele shqipe. Në njënen paralele kanë qenë krejt mashkuj dhe paralelen tjetër ku kam qenë edhe une me shoqet e mia, kanë qenë njo 15 vajza edhe tjerët mashkuj. Muj me thanë se perioda ma e bukur e jetës time ka qenë në gjimnazin e Pejës. Kem pasë një shoqni shumë të singertë edhe shumë të mirë. Çdo pushim ose çdo ndojhere si gjithë nxanësit tjerë, ndojhere edhe kem ikë edhe prej orëve (qeshë), edhe i kem shfrytëzu ato për me shku deri te burimi, te kisha atje. Mandej, kem bo edhe shumë shëtitje



edhe në Radavc, kështu që deri në maturë kem kalu shumë bukur.

Matura ka qenë në vitin '61-'62, domethonë kem qenë maturanta. Atëhere, natyrisht se nuk boheshin organizime me festu mbramjen e maturës si tash që po bohet, s'kishte as lokale, as kurgjo. Ne e kishim kopshtin shumë të madh edhe shpinë e kishim të madhe, se axha më ka vdekë fatkeqësisht, edhe axha më ka vdekë heret në vitin '57 kur unë kom qenë në vitin e dytë në gjimnaz. Fillimi i vitit të dytë në gjimnaz. Edhe vllau ka qenë dikun në shkollën fillore. Edhe për ne kjo ka qenë edhe një goditje se mbetëm pa... mbetëm vetëm me grunë e axhës. Gruja e axhës gjithashtu ka qenë një gru shumë bujare, gru shumë e mirë e cila nuk e ka pasë kërkend të vetin. S'ka pasë vlla, s'ka pasë motër, e vetme, plus e ka pasë një djalë të axhës – babën e Dervish Rozhajës.

Du me cekë edhe këte për Dervish Rozhajën. Dervish Rozhaja atëherë ishte student në Beograd dhe një student shumë i dallum, i cili mandej doktor shkence, ma i riu në ish-Jugosllavi ka qenë, dikun në moshën njizetë e diçka vjeçare ka doktoru. Ai sa here vijke prej Beogradit me vizituë familjen, rrijke një ditë dy në familje edhe menihere vijke te na, sepse ktu kishte libra me lexu, domethonë kishte dëshirë me ardhë ktu për me u asi... në një mënyrë shpija jonë ka qenë, e kanë frekuentu shumë njerëz të cilët e kanë dashtë librin, e kanë dashtë domethonë... kanë ardhë njerëzit të cilët kanë qenë të interesum në atë kohë, në atë kohë ka pasë shumë pak libra në gjuhën shqipe domethonë, edhe gjitha ato revistat, ato librat jonë shfrytëzu prej... ka ardhë Dervish Rozhaja, ka ardhë një kushëri i joni Hasan Bala, i cili studionte më duket për teknologji në Sarajevë. Mandej, Jusuf Gërvallën e kem pasë ktu kojshi, se ai u rritë te daja. Edhe ai shpesh vijke, ka qenë dikun gjeneratë me Kujtimin, ndoshta një vjet ma i ri se Kujtimi. Edhe vijshin këtu u mbledhshin të gjithë. Derisa tjerët lujshtin me top ose diçka, Jusufi hypke naltë atje në çardak edhe i merrke ato libra, revista ka qenë prej fillimit, ka qenë i interesum për lexim.

Dashta me ju tregu edhe këtë ngjarjen e maturës. E krymë maturën, dojshim me bo diçka me organizu, edhe u mbledhëm po bisedojmë. Domethonë, kem qenë një shoqni shumë e sinqertë edhe shokët e klasës kanë ardhë te une, na kem shku te shokët e klasës, nuk kem pasë ashtu ngurrime, ato... një shoqni shumë e sinqertë. Thotë, "Të kishim me u taku me u mledhë diku, po s'po kemi ku". Edhe une tash, "Une po e pys grun e axhës çka po më thotë edhe vijmë. Na e kem kopshtin ktu, edhe mledhëm në kopsht". Une p'e... tha, "Po nonë, ma mirë me ardhë këtu, se me shku tjetërkah. Ejani". Kishim kopshtin shumë të madh e të bukur. Ishte një pishë, pisha sot e kësaj dite osht' aty, të cilën e ka mbillë axha im diku në vitin 1931 kur u ble kjo shpi, shpija këtu që osht' e vjetër e babës. Atëhere erdhën shokët e klasës, e rregullum, i qitëm dritat, natyrisht muzikë e krejt (buzëqeshë). Krejt... ka qenë ngjarje edhe për krejt rrethin, se s'ishin, nuk organizoheshin atëherë. Edhe krejt kto muret përreth {tregon kah muret e dhomës} kojshitë kishin hypë me pa çka po bojmë na, çka po knojmë e po lujmë (qeshë). Edhe, ajo kangë osht' si një kujtim i bukur prej mramjes të maturës që e kem festu bashkë.

Kryhet matura. Ishin shumë të pakëta mundësitë për me shku në studime. Mandej axha na kishte vdekë, nuk kishim kurrëfarë burimi për jetë. Natyrisht kem qenë familje ekonomikisht, kem qenë në rregull domethonë, se na ka lonë axha pasuni, shpinë e tokën, e nuk kem hekë kështu. Mirëpo, për ndonji asi... plus gruja e axhës ish e lidhun shumë për ne, kështu që asaj i dukej shumë e vështirë une

tash me lonë, ishte e vjetër, relativisht e vjetër, me lonë une edhe me shku në studime. Edhe une isha pajtu me ato, e kom kry maturën edhe mjafton. Mirëpo, daja im Esat Mekuli i cili ka pasë një kujdes shumë të madh për ne, në vitin '56 kur ka ajo bora e madhe në Pejë, dy metra, bora e kuqe i thojshim. Se në mes të borës ka qenë edhe një shirit qështu katër gishta {tregon dimensionet me pëllëmbë}, ka qenë një shirit i kuq. Bora dy metra ka qenë, domethonë o blloku krejt, çdo gja. Thojshin se prej kur kanë fry erënat në Afrikë, e kanë pru atë zallin prej shkretëtinave.

Nejse, edhe daja im martohet me Sahadete Doku Mekuli, e Ohrit, mjeke. Edhe e bjen me vizitu dy motrat që i kishte të martume ktu në Pejë. Vijnë me tren natyrisht, se kjo rrugë s'ka ekzistuar, vetëm treni. Vijnë me tren edhe prej trenit me saja se s'kanë mujtë. Dhe kur kanë ardhë këtu te kjo rruga jonë para shpisë tonë, i thotë grusë të dajës, kto ma ka tregu gruja e dajës, thotë, "Sahadet, ktu i kom dy fëmijë të motrës, na po shkojmë m'i vizitu edhe ato motrat tjera. Ti çka bon me kto motrat tjera, a m'i respekton a i don osht' çashtja jote. Qeta dy fëmijë, du me m'i kqyrë si me qenë fëmijë tanë". Edhe asej i ka mbetë ajo... {qet dorën në gjoks}. Mandej masi vizitojnë, vijnë na vizitojnë edhe neve edhe ne çdo pushime shkojshim, masi gjyshi e gjyshja kalojnë në Prishtinë, na shkojshim për çdo pushime, shkojshim te daja, te gjyshi e te gjyshja. E kreuva maturën edhe u ndala me aq.

Vjen daja me grunë e vetë, edhe i drejtohen grusë të axhës. I thojnë, "Xhixhë," xhixhë i thojshim, "na jem ardhë me marrë Lulen për studime, me marrë në Prishtinë me studiu atje". "Ouu," ajo ia nisë me qajtë thotë, "Une i kom rritë kta fëmijë, tash po doni me m'i marrë të gatshëm" natyrisht si edhe çdo prind. Thotë, "Nuk bon me lonë me maturë, osht' gjynah, dojmë me marrë". Ma në fund ajo bindet, "Mirë," thotë, "atëherë une Kujtimin du me martu, s'muj une me ndejtë vetun, ju po ma merrni çikën". Kujtimi osht' ma i ri se une (qeshë), domethonë 17 vjeçar. Ata fillunë me qeshë (buzëqeshë).

Nejse, edhe erdh koha une me shku në fakultet. E kujtoj atë ditë me shumë mall edhe me një, une i përgatitsha teshat në kofër për me shku për Prishtinë, gruja e axhës m'i nxirrke teshat prej koferi. Ajo qante pse une po shkoj në Prishtinë, une qajsha pse ajo nuk po më len me shku në Prishtinë me vazhdu studimet. Edhe ma në fund kur e pa që mo veç u lodha, "Hajt çika jeme, paloj teshat", e msheli koferin, "Hajde po të përcilli deri në stacion". Veç m'i qiti edhe kushtet, "Për çdo javë ki me ardhë me ma pastru krejt shpinë, me m'i bo krejt punët, me m'i la teshat, krejt ato". "Krejt," thashë, "për çdo javë, unë kom m'i bo." Edhe me ë 'vërtetë kom ardhë për çdo javë me ia rregullu. Jo, se nuk muj, po e vjetër ka qenë (buzëqeshë).

Regjistrohna në Fakultetin Juridik, ishte gjenerata e dytë e Fakultetit Juridik në kuadër të Universitetit të Beogradit. Isha vetëm une shqiptare, ishte edhe një tjetër e Mitrovicës një Mykelefa Shabanoviç. Nanën e kishte myslimane e babën shqiptar, po nuk e dijkë shqipen shumë, mirëpo e mante veten si shqiptare. Edhe ishin nja katër-pesë serbe malazeze, disa ishin ardhë prej Serbisë, disa prej ktuhit, edhe të gjithë profesorët i kishim prej Universitetit të Beogradit edhe të Shkupit. Domethonë, mësimi zhvillohej në gjuhën serbo-kroate. Diku kem qenë 56-57 vetë mashkuj e femna krejt. Në gjeneratë me mu ka qenë edhe Adem Demaçi. Adem Demaçi e kishte kry Albanologjinë e mandej regjistrohet edhe me kry edhe Juridikun. Domethonë, ishte viti '62-'63 kur unë regjistrohna në Fakultetin Juridik. E kryj vitin e parë, e kryj vitin e parë me sukses. Regjistrohna në vitin e dytë, i ndëgjoj ligjëratat, jepi

shumicën e provimeve. Mësojsha se e kisha edhe atmosferën te daja shumë të mirë. Domethonë, edhe atje me libra, me biblioteka, mandej i kisha bisedat me grunë e dajës, me dajën, të gjithë më motivojshin për me msu sa ma shumë.

Edhe du me tregu ktu një detal për Adem Demaçin, ishte po domethonë viti '63, '63, ishte... organizohej Seminari i Gjuhës Shqipe në Prishtinë. Ishte hera e parë që organizohej seminari, dhe ishim në një landën Fillet e së Drejtës, ishim me një profesor prej Beogradit që na majke ligjëratat. Muj me thanë, edhe këtu muj me thanë se profesorët që kanë ardhë prej Beogradit kanë qenë shumë korrekt. Na kanë mbajtur ligjëratat shumë mirë, kanë majtë edhe ushtrime. Edhe në një moment t'u... ligjëratat, ky Adem Demaçi e çon dorën edhe kërkon leje prej profesorit, thotë, "A bon me më liru se mbahet ligjerata, Seminari i Gjuhës Shqipe në Prishtinë edhe unë jom gjuhëtar, kom dëshirë me shku me marrë pjesë në atë seminar." Tha, profesori e pyetë, iu drejtu, "*Albanskog jezika?*" Atëhere ishte *Šiptarski jezik* dhe ishte *Albanski jezik* (buzëqeshë), ishin dy gjuhë. Ky Adem Demaçi çohet edhe e mban ashtu, një rafall si me thanë një ligjeratë të vogël (qeshë). Thotë, "Na jemi për ju, jemi të gjithë *albanci* për të hujtë, për ne na jem shqiptarë, për veti. Edhe gjuha nuk ka dallim *Albanski jezik* osht' gjuha shqipe, osht' e njejtë si në Shipni, si kudo që flitet o gjuha shqipe." Qaq shumë e mbajke me emocion e asi, saqë ai profesori i erdh keq që kërkoj falje, "Më fal, më fal, të lutem, unë s'kom ditë që ka asi. Kom mendu që ka dallim mes gjuhës shqipe dhe gjuhës... *albanski jezik* edhe *šiptari jezik*", nejshe edhe ai del prej atje. Ky osht' moment për Adem Demaçin.

Edhe erdhi fundi i vitit të dytë, viti '64. Viti '65 ishte për Kosovën vit mjaft i randë se ishte aksioni kur i qitën flamurat ma s'pari, edhe u burgosën shumë të ri e të reja. Edhe, mu më kishte mbetë edhe një provim me dhanë, me një moment vikendi ishte edhe unë i thom grusë të dajës, provimin e kisha edhe dy-tri ditë, i thom grusë të dajës unë duhna me shku për Pejë. Ajo, "Mos shko për Pejë, e ki provimin, duhesh me dhanë". "Diçka ka ngja," unë nuk dijsa çka ka ngja, "une gjithqysh duhna me shku për Pejë". Me tren vijmë në Pejë. Kur vijmë në Pejë këtu bash afër shtëpisë, në këtë udhëkryqin për shkollën "8 marsi," aty del një vajzë edhe më thërret "Luljeta, a je mirë, a je...?" Unë "Po, pse?" Thotë, "Kanë qitë fjalë se ty të kanë burgosë edhe të kanë pa me, të lidhun me hekra në durë, të kanë çu në burg". "Jo," thom. "Pse çka ka ngja?" Thotë, "Mos vet çka ka ngja? Ma kanë marrë në burg Selajdin Dacin". Ishte motra e Selajdin Dacit. Kanë marrë në burg shumë tjerë, Shefqet Deçanin e shumë njerëz këtu, të cilët si duket ishin të organizum.

Kur vij te shpija, shpija ish bastisë ish bo krejtësisht, kishin çdo gja e kishin kthy, e kishin asi. Ftesa për bastisje kishte ardhë në emën timin. Edhe aty përmendej edhe neni i cili ligjit penal atëhere të Serbisë. Kur vij e gjoj grunë e axhës të shtrime në shtrat, gati pavetëdije, vllaun ma kishin marrë në polici. Edhe une i afrohna grusë, edhe asaj i kishin thonë se Luljetën e kanë marrë në burg. Ajo ishte tmerru krejtësisht, thotë, "Tash boll e kalumë atë kohë, atëherë tash prapë me na ngja të njejtat..." Edhe une vij e i afrohna "Xhixhë, xhixhë!" "Kush je ti?" Nuk po më njeft, "Luljeta!" "Jo, Luljetën e kanë marrë në burg. Më kanë thonë që e kanë pa me durë të lidhuna". "Jo," thashë "unë jom Luljeta". "Kujtimin ma kanë marrë në burg". Une u tmerrova çka pashë. Po pres, mas pak po vjen Kujtimi. Ata e kishin lshu edhe i kishin thonë se gjithsesi duhet motrën me e thirrë me ardhë, se a osht' në Prishtinë në studime,

me thirrë me ardhë ktu se Letërthirrja osht' në emën të sajna. Arsyeya pse ishte bo kjo, nuk e di pse. Ndoshta pse e kishim atë dangën si familje, ndoshta edhe pse në fakultet atje isha edhe kolege edhe me Adem Demaçin nuk di, nuk di pse. Edhe, vjen Kujtimi më tregon, thotë, “Lule nesër në ora 8:00 duhesh me shku në Sekretariat”. Natyrisht se më erdhi rondë, po s’kisha çka me bo, duhej të nesërmen. Besa, jo në ora 8:00 në mëngjes, po i kishin thonë dikur mbasdite, kur të dalin ata shërbysit prej atyhit.

Të nesërmen... bastisja ishte bo, ishin marrë disa libra që kanë mbetë. Edhe do revista që kanë mbetë prej librarisë. Na në mur, qysh e ka pasë vendosë baba një fotografi të madhe të Skënderbeut, nuk e kem lëvizë kurrë prej murit atë fotografi, ajo ka qenë aty Skënderbeu. Edhe atë fotografi tha e kanë... kanë pytë, “Çka po ju duhet? Çka po ju duhet kjo fotografi ktu?” Demek Skënderbeun me mbajtë. Nejse, në ora dy të nesërmen vjen Kujtimi me mu edhe shkojmë në Sekretariat. Në Sekretariat, Kujtimin nuk e lojnë me ardhë nalt, e ndalin poshtë. Edhe mu, natyrisht se derisa i kom hypë ato shkallave, zemra jeme e din e ka përjetu shumë rondë, mirëpo mandej e kom marrë veten edhe e kom hypë në dhomën ku më drejtunë me shku.

Aty ishte një shqiptar, emnin nuk po muj me ia ditë s’po më kujtohet, mbiemnin Haskaj, të cilët kishin marrë pjesë këtu në bastisje. Edhe mbi tavolinë e kishte qitë një libër të Zogut, martesë e Zogut me ato fotografitë e Xheraldinës e ato motrat e Zogut e krejt. Disa revista aty edhe filloi pytja... gjoja se une i kom furnizu shokët e klasës me libra, gjoja... e kem pasë “Lahutën e Malcis” ju kom dhonë me lexu... e qësi ia nisi gjëthfarë asi. Une e mohojsha, thojsha, “S’osht’ e vërtetë. Hiç s’osht’ e vërtetë”. Kur e pa qi më dha Zoti njëfarë force me u përmbajtë (buzëqeshë). Kur të gjitha i mohova thashë, “Nuk osht’ e vërtetë”, atëherë filloi tha, “Kom dashtë me kapë atë fotografinë e Skënderbeut edhe me shkelë me komë edhe me e thy”. “Po,” thashë, “çka ka lidhje Skënderbeu me këtë periodë? Skënderbeu dihet kur ka jetu, ai osht’ një shëmbëlltyrë historike. Kjo nuk ka lidhje me kurgjo, ai osht’ shëmbëlltyrë historike. Po edhe që e kishit bo, s’kishit bo noj trimni të madhe që kishit thy fotografinë e Skënderbeut. Plus ajo fotografi qysh e ka vendosë baba im, qatyt osht’ nuk e kem ngucë”.

Edhe, nejse filloi prapë edhe me kërcënime. Aty e kishte edhe revolen afër te tavolina, tha, “Mirë, ti nuk po don me folë, me më tregu, me pranu ktu”. Thashë, “Unë s’kom çka me pranu, se s’jonë kto të vërteta kurgjo. Jo natyrisht se dora e pushtetit osht’ e gjatë, mundet me bo çka të don, mirëpo unë nuk kom çka me thonë tjetër”. “Mirë,” tha, “ti nuk don me thonë para meje, po jonë tjerë që s’ki qare pa i thonë”. Edhe une dal shkallave teposhte, vij te shpija, Kujtimi s’osht’. Kujtimin e kanë, policët e kanë shti mrenda atje, tash ai po frigohet për mu çka po bojnë me mu atje nalt. Unë tash po frigohna e kanë mbyllë Kujtimin masi më lshunë. Kanë qenë drama, drama shumë të ronda.

Mbas një kohe, Kujtimi i pytë ata e thotë, “More, motra çka ka ba?” “Jo,” thojnë “motra ka dalë” edhe vjen Kujtimi mandej këtu te shpija (buzëqeshë), nejse gëzimi ishte i madh. Mbas asaj mo nuk më kanë... mandej ma vonë fillunë domethonë ramja, filloi veç ajo era e ramjes së Rankoviqit, vitet e... Eh, gruaja e axhës smutë në shtrat. Kur na pa të dyve natyrisht se ajo u bo... prej asaj dite ajo nuk u çu mo prej shtratit, tetë mujë ka qenë e smutë, une i ndërpreva studimet se s’mujsha me e lanë. S’mujsha me lanë, s’kish kush me kqyrë. Ajo mas tetë mujve vdiq. Dhe, ka qenë për ne një goditje shumë e randë,

goditje shumë e randë. Natyrisht edhe sëmundja, iu keqësu gjendja, situata, vdiq.

Unë mbeta ktu në Pejë, vllau shkoi në studime në Sarajevë. Mandej, unë njoftohem me Ademin bashkëshortin tim. Dhe, mbas një kohe Ademi ishte student në Beograd, ishte kah fundi. Kur i kryen studimet, një kohë jemi argëtu edhe mandej jemi martu në vitin '65, '65. Martesa ime me Ademin ka qenë temë diskutimi nëpër konferencat e Partisë Komuniste, po se ne ishim dy fëmijë e baballarëve që ishin pushkatu. Se edhe Ademit ia kanë pushkatu babën ktu në Tabje. Ktu kanë pushkatu shumë qytetarë të Pejës edhe të njoftun. Sidoqoftë, (qeshë) dashnia osht' ma e fuqishme se krejt, tonat, edhe ne martohemi në vitin '65.

Ademin e pranojnë në punë në një kooperativë bujqësore diçka, mbas dy muje i vijnë karakteristikat ku me ditë prej kah edhe e përjashtojnë prej pune dhe e çojnë ushtar. Unë mbes vetun prapë, vllaun e kisha në studime. Mbes vetun, mirëpo vjen vjehrra jeme me jetu këtu në shpi të babës se shpija ishte vetun. Duhej dikush me ndejtë aty me mbikqyrë. Vjen vjehrra ime edhe domethonë një vjet, mas nëntë muajve më lindë djali se isha shtatzanë, më lindë djali Mentori, djali i parë. Edhe, në një mënyrë, domethonë plotësohet pak jeta, kujdesna rreth fëmijut, rreth punimit të kopshtit se s'kishim edhe burime për jetë, s'kishim shumë.

Vjehrra punojke në një... ishte punësu sado kishte metë shumë e re, e vejë 22 vjeçare me dy djem jetima, o dashtë me i shkollu ata fmijë, o detyru me hi edhe në punë, njifarë kooperative diku ka punu. Njanin djalë e kishte në Prizren, Mehdi Bajri, studionte muzikën, shkollën e mesme të muzikës. Ademi ishte në Beograd, duhej me i çu pare edhe atij në Beograd, atëhere domethonë. Kështu që, mbas një vjete Ademi ka qenë në Bostonë ushtar, mbas një vjete kthehet, edhe e pranojnë në punë në Gjykatën në Gjyrovoc. Mbas Gjyrovocit kthehet në punë në Gjyqin e Pejës, Gjyqin e Pejës.

Atëhere Ademi, prej Gjyqit të Pejës, Gjyqit Komunal si praktikant në Gjyrovoc kalon në Gjyqin Komunal në Pejë. Natyrisht se atëhere fillojnë pak edhe demokratizimi era, deri atëhere gjykimet ishin mbajtë në gjuhën serbo-kroate. Tash kur vijnë gjyqtarët shqiptarë fillojnë proceset gjyqësore m'u mbajtë në gjuhën shqipe edhe veç fillon një frymë tjetër nëpër gjyqë. Unë do të ju tregoj vetëm një detal. Kur ka fillu punën Ademi në gjyq, i vjen një i fshatit një punë që ka pasë në gjyq edhe ai përpara kur ka ardhë, deri sa ka ardhë në gjyq, gjyqtarët kanë qenë serbë. Dhe e kanë detyru para zyres të gjyqtarit ku ka qenë, me i hekë këpucët, me e hekë ato, me e heqë kapelën osht' deshtë, kapuqin e bardhë edhe me i hekë këpucët edhe me hy aty. Edhe ata qysh ishin mësu në atë... Ademi tash, Ademi ishte aty gjyqtar edhe vjen i hekë këpucat i shkreti, edhe ashtu i përvujtun dhe [ky] i drejtohet, "Pse i ke hekë këpucat?" Thotë "Na kanë detyru me i hekë këpucat, nuk ke mujtë me hy këpuca aty". Thotë, "Kthehu veshi këpucat!"

Ka fillu një frymë e re në gjyqë, aty jonë punësu mandej shumë përpos Ademit, ka qenë Abdyl Aziz Daci, Shefqet Deçani, kryetar i gjyqit ka qenë Mikel Marku, një njeri i cili i ka përkrahë shumë, i cili i mandej tragjikisht ka pësë, t'u e rrahë e kanë mbytë aty në vitet '90, '98, '97 ashtu. Tu e pa se situata në gjyqë po ndryshon, ka fillu një liberalizim, ato seancat mbaheshin në gjuhën shqipe, krejt... në një moment ka qenë viti '71 po më duket, del letra e Titos. Letra e Titos, e cila i gjykon, domethonë i gjykon këto...

procese që kishin fillu nëpër gjyqe. Jo vetëm në Kosovë, po krejt më duket ka qenë një fushatë në krejt Jugosllavinë.

Mirëpo, ma së shumt natyrisht që sulmohen gjyqet shqipe, edhe sipas kësaj letre përjashtohen nga gjyqi Ademi edhe Abdyl Aziz Daci. Përjashtohet edhe një serb, gjoja me ballancu pak situatën se nuk po sulmohen vetëm shqiptarët po edhe ata serbët, edhe ata serbët ka qenë një gjyqtar i dështum, i cili ka pi shumë raki... nejse çashtja e tyne, i përjashtojnë. Kjo osht' goditja e dytë, përjashtimi i dytë prej punës. Edhe ne mbesim prapë pa kurrëfarë burimesh për jetë.

## Jeta Profesionale

*[Pjesë e prerë nga video-intervista: intervistuesja kërkon nga e intervistuarja të flet për jetën profesional dhe aktivizmin]*

**Luljeta Myftari Bajri:** Në ndërkohë unë pranohna në shkollën fillore “8 Marsi” si sekretare e shkollës, njëkohësisht vazhdoj edhe studimet me korrespondencë në Prishtinë, sepse dajës tim i kishte ardhë shumë randë ajo pse i kisha ndërpre studimet. Edhe vazhdimisht më thojke, “Luljeta, ti duhesh me kry fakultetin”. Natyrisht e kom pasë përkrahjen shumë të madhe edhe të dajës edhe të grusë të dajës. Shkojsha me fëmi të vogël, ma kqyrshin ata fëminë (buzëqeshë). Unë mësojsha natën edhe shkojsha i jepsha provimet. Tash e kisha pak ma vështirë se i kisha ndëgju krejt ligjeratat në gjuhën serbo-kroate edhe librat i kisha, literaturën serbo-kroate. Tash kish fillu veç ajo Universiteti i Prishtinës, kush ishin pranu shumë profesorë në gjuhën shqipe. Edhe gjenerata ime, tre-katër prej gjeneratës sime kishin mbetë aty si profesorë Avni Gjakova, Hasim Loshi, Faik Brestovci, nuk di edhe disa tjerë. Kështu që, tash e kisha shumë vështirë, duhej me msu edhe ma tepër, mos me dalë para... duhet me i dhonë provimet para kolegëve të mi që kisha qenë në fakultet. Nejse, e krymë edhe ato. E krymë për një kohë relativisht asi... edhe punojsha, edhe...

Kom pasë fatin që jom pranu në një shkollë, në një kolektiv të mrekullshëm, shkollën “8 Marsi”. Edhe pranimi im aty ka qenë pak i vështirë. Po ju tregoj kto detaje se jonë, jonë me interes me ditë çfarë atmosfere ka qenë atëhere. Konkuroj aty, natyrisht konkurrojnë edhe disa tjerë, po i plotësoj kushtet, edhe prej Komitetit ose Lidhjes Socialiste, vjen në shkollë, “Nuk bon me pranu se ajo osht' e papërshtatshme. Osht' bija e Emrush Myftarit”. Unë aty e kisha si koleg edhe msusin tim, të cilin e kom dashtë shumë edhe ka qenë shumë msus i mirë, Kamber Pajaziti. Kamber Pajaziti t'u më njoftë mu si nxanëse, tu e njoftë edhe familjen time, kundërshton. Thotë, “Çka ka lidhje pse osht' bija e Emrush Myftarit? Ajo osht'... e ka kry shkollën, une e njof si nxanëse qysh prej shkollës fillore, nuk bon mos me e pranu”. E natyrisht une pranohna. Mirëpo, tashti fillojnë kundër mësusit pse kishte folë me më përkrahë mu. Edhe, e denojnë kto organet e Lidhjes Komuniste kur kanë qenë ato mledhjet. Ai detyrohet me lshu punën aty në shkollë edhe me shku në Prishtinë. Me lshu punën detyrohet, domethonë vet me e lshu punën, për mos me degradu, mos me përjashtu e lshon punën e shkon në

Prishtinë. E krejt familjen e ka pasë ktu në Pejë.

Unë këtë fakt e kom marrë shumë vonë vesh. Nuk i ka tregu kërkujna. Mandej, i kish tregu dikujt edhe më ka tregu. Nejse, vazhdoj une punën aty, sekretare e shkollës. Shkolla jonë muj me thonë se ka qenë ndër shkollat me renome, jo vetëm në Pejë, por edhe ma gjerë. Ka qenë një kuadër shumë i mirë, kem pasë kushtet për punë shumë të mira. Shkolla ka pasë kabinetet e gjitha të mundshme, e biologjisë, fizikës, kimisë. Kem pasë... kem projektu filma, kem pasë filma, për çdo javë ju kem dhonë filma. I kem marrë prej Qendrës Kinematografike në Prishtinë nga një film, natyrisht me tematikë që i përshtatej nxanësve. Domethonë, ka frymu shumë shlireshëm edhe shumë bukur. Kem pasë bibliotekë, kem pasë mandej seksione të ndryshme të aktiviteteve. Edhe nxanësit e shkollës kanë qenë të dallum, gjithnji kanë fitu edhe nëpër kto konkurset që mbahen të diturisë, kanë fitu vendet e para.

Vjen viti '81, demonstratat të cilat natyrisht i përjetojmë shumë randë. Ata që kanë qenë edhe dëshmitarë okularë, që kanë pa tmerret që kanë ngja gjatë atyne demonstratave, mirëpo o mundu gjithnji me i heshtë, mos me u marrë vesh. Gruja e dajës e cila ka qenë drejtoreshë e repartit e gjinekologjisë, e përgatitë spitalin për me i pranë të plagosunit në spital. Me gjithë vajzat e veta i veshë me mantilla të bardhë edhe i bajnë sa munden të plagosunit në spital m'i strehu. Prej atij momentit, ajo ka qenë, ka përjetu sulmet të hatashme. Une kom qenë edhe dëshmitare e letrave kërcënuse që i kanë ardhë prej serbëve, prej malazezëve, prej... gjoja... e për këte, edhe për dajën tim ka qenë një gja shumë e randë, se kanë punu me mish e shpirt për çashtjen e përgjithshme për popullin. Daja në një relacion krejt tjetër për kulturën, kjo tjetra për shëndetësi. Plus, ka qenë edhe profesoreshë në Fakultetin e Mjeksisë, atëherë fillojnë për familjen tortura, presione edhe kjo e goditë shumë randë dajën tim. Mirëpo...

## Aktivizmi

*[Pjesë e prerë nga video-intervista: intervistuesja kërkon nga e intervistuarë të flet për përvojën e saj si aktiviste.]*

**Luljeta Myftari Bajri:** Fillon prapë një periudhë shumë e randë për popullin shqiptar. Ajo koha e cila kishte qenë prej vitit '71, prej themelimit të Universitetit të Prishtinës deri në vitin '81, kishte qenë një bum, një përparim shumë i madh i popullit shqiptar. Meqë ishin shkollu shumë të rinjë edhe kishin arritë sukses, edhe me të vërtetë ka qenë shkollim cilësor, për kohën që ka jetu se kanë punu si profesorët me përkushtim, edhe studentat kanë mësu me përkushtim, që fatkeqësisht, sot pak ka ndryshu. Ajo jetë... ne kishim kalu familje, domethonë vllau im kish kriju familjen e vetë, ishte martu me një kolege atje prej Sarajevës, studente. I kishin lindë dy fëmi Arbeni edhe Florina, dy fëmi të mbarë edhe shumë të mirë. Mu më kishin lindë, i kisha tash tre djem, kisha Mentorin, Ilirin edhe Gazmendin. Edhe kta ishin rritë së bashku edhe fëmitë e vllaut, edhe fëmitë e mi. E kanë çu një fëmini shumë të bukur edhe shumë të lumtun.



Erdh viti '81. Unë them se gati te andrrat, në një mënyrë u... rranjosën. Domethonë, e dishim se po na vjen një periudhë shumë e randë. Mirëpo, atëherë filloi edhe Lëvizja, mbas demonstratave të '81-shit, u burgosën shumë të rinjë, u dënun me burgime të gjata. U mbajtën shumë procese gjyqësore. Nëpër shumicën e ktyne proceseve ka qenë mbrojtës edhe bashkëshorti im Ademi. Masi e përjashtunë prej gjyqit, ai regjistrohet, e jep provimin për... në fakt, provimin e kishte dhanë gjyqtari edhe mund të merrte edhe licensën e avokatit. Edhe fillon me punu si avokat dhe i mbron shumë të rijë që ishin dënu në këto procese gjyqësore.

Natyrisht se fëmijtë tanë e vazhdunë shkollën. Erdh koha e studimeve, erdh viti '91, edhe një goditje e randë për popullin shqiptar, mbyllja e shkollave shqipe. Ne të cilët e kishim përjetu periodën e pas Luftës së Dytë Botnore, edhe sidomos për vllaun tim i cili punonte në gjimnazin e Pejës, edhe ishte një profesor shumë i respektum i filozofisë, e përjetoi shumë randë largimin prej shkollave. Tash e kishte brengën për fëmijtë e vetë, se sidoqoftë ne, përkundër që ishim familje e anatemume, nuk... shkollimin nuk na e kanë pengu. Ashtu qysh kem mujtë, e kem vazhdu. Për dallim prej Shipnisë, andej familja kur ka qenë asi... krejt familja osht' skeju s'ka mujtë edhe me vazhdu shkollimin.

Atëhere, largohem prej shkollave, detyrohem që shpijat me i shndërru në shkolla. Me një moment, të gjithë personeli arsimor mbetet pa rroga. Duhej me bo diçka, duhej me shpikë një organizim ndryshe. Edhe vllaun tim e kishin caktu me një komision për mbledhjen e ndihmave. Për me ndihmu ktyne, arsimtarëve që kishin mbetë pa rroga, se ata s'kishin burime tjera të jetës. Unë kur e ndiva ate, natyrisht më erdhi mirë, por e ndiva edhe njëfarë shqetësimi në zemër se e disha që ish shumë i ndishëm edhe ka me i kushtu me shëndet ajo.

Në vitin '91... ai ka qenë përndryshe, fizikisht ka qenë shumë i fuqishëm, ka qenë, ka qenë shumë i durushëm... mirëpo, si duket krejt atë durimin e ka palu. Në vitin '91 përjeton një infrakt të randë edhe vdes në moment. Për mu ka qenë një goditje shumë e randë, tash më dukej ajo vdekja e prindërve gati kojshi në krahasim me kto çka ngjau me vllaun. Mirëpo, duhej gjetë forcë, duhej gjetë forcë që të kujdesesha edhe për grunë e vllaut, për fëmijtë e vllaut, për fëmijtë e mi. Ta merrsha pak ma me... si me thonë, me durim, me forcë këtë dhimbje të madhe. Dhe jom mundu mos me u dorëzu. Atë dhimbjen e madhe jom mundu me e shndërru në forcë për m'i përballu të gjitha këto sulme, të gjitha këto goditje që na i kishte përgatitë jeta. Fëmijtë e vllaut mbesin natyrisht në moshën ma delikate. Vajza 13 vjeçare, djali dymdhetë vjeçar. Fëmijtë e mi ishin pak ma të rritun, kështu që u gjetën në mes veti njëfarë...

Në horizont shihej se diçka do të përgatitej për Kosovën. Ishte rezistenca paqësore prej '91-shit, deri në vitin '98-'99 kur veç u bo ma se e domosdoshme me u bo diçka, se nuk shkonte mo me atë rezistencë paqësore. Edhe pse, ajo e ka meritën e vetë të madhe për internacionalizimin e çështjes shqiptare në botë. Se qaq shumë ishte mundu Serbia, me propagandën e saj, me librat e saj, me paraqitë popullin shqiptar si një popull pa kulturë, si një popull që nuk meriton me pasë shtet. Një popull... si me thanë, një popull të egër. Ishin dëshmitarë të një kohe që duhej të gjithë aq sa dijshim, dhe aq sa mujshim me bo diçka për çashtjen e përgjithshme. Kështu që, organizohem me gratë ktu të Pejës, organizohem në Forumin Demokratik të Grusë. Natyrisht, me iu ndihmu femnave, me shiqu për çashtjen e arsimit. Ndihmat që duhej me i mledhë...



**Lura Limani:** Në cilin vit jeni organizu?

**Luljeta Myftari Bajri:** Në vitin '91, në vitin '91-92 qatëhere jemi formu.

**Lura Limani:** Qysh doli idea, apo si jeni taku?

**Luljeta Myftari Bajri:** Po natyrisht, e kemi formu kryesinë e punës, mandej kemi pasë degë në të gjitha fshatrat. Kem shku, kem mbajtë... nëpër fshatëra i kem vizitu, ju kem dhonë këshilla grave, iu kem ndihmu qaq sa kem mujtë. Edhe, vjen përjashtimi i punës i gjithë shqiptarëve viti '91-'92, prej shkollave, prej punës, domethonë krejt ai kuadër, sidomos femnat të cilat kishin kry fakultete, edhe formojnë komisionin për regjistrimin e largimit të femnave prej punës, prej shkollave, prej punës. Edhe i kom pasë edhe shënimet diku po... aty vrehet se numri ma i madh i të përjashtumeve ka qenë i ato të cilat kanë pasë kuadër të lartë profesional. Mandej, vijnë kto me kuadër të lartë, me kuadër të ultë edhe ato tjerat në shkollë fillore edhe nuk i kanë asi...

**Lura Limani:** Prej "8 Marsit", a ju kanë largu juve?

**Luljeta Myftari Bajri:** Jo, jo. E mund të them se "8 Marsi" ka qenë si një oazë e arsimit. Meqë kem qenë shkolla etnikisht të pastër nuk kem pasë asnjë paralele në gjuhën serbo-kroate. Edhe pse, kanë tentu disa herë m'i hapë paralelet, mirëpo ishte rrethi që nuk kishte nxanës, kem qenë etnikisht të pastër edhe kem vazhdu mund të them në mënyrë pak ma normale punën. Përkundër, shpesh, ardhjes së policisë, kërcënimeve, ato... mandej, në shkollën tonë jonë strehu edhe tri shkolla tjera: Shkolla e Artit, se i kanë largu krejtësisht; Shkolla e Mjeksisë, për katër-pesë vite kanë ndalë msimin, edhe Shkolla e Lartë Komerciale, në këtë shkollën e vogël ktu te hamam xhamia që osht', edhe kjo ka qenë në kuadër të shkollës "8 Marsi".

Kadale, kjo rezistencë zihet se nuk bon me shku deri në fund edhe në vitin '98 osht' sulmi në familjen e Jasharajve, në një mënyrë, veç del në pah se lufta osht' e domosdoshme. Pas vdekjes së vllaut, pas përfundimit të luftës e kisha një, mund të them edhe një andërr, një andërr që të bojsha diçka, që të delte në pah diçka gjithë ajo veprimtari edhe ajo jetë e babës sim. Materialet, shkrimet e kishte pasë personalitetin dhe jo vetëm kto të Kosovës edhe Jugosllavisë, mirëpo edhe me personalitetet të Francës e Anglisë. Ia vuna vetit për detyrë me shkru, me folë për një monografi sado të vogël, s'paku të mbetet për gjeneratat, le të dijnë, se kur vijnë edhe nipat e mi s'kanë me ditë për familjen e gjyshit të vet ose stërgjyshit.

Në Tiranë e kisha djalin e axhës Esat Myftarin i cili në vitin '63, kishin ikë për Shqipëri. Kishte ikë Esat Myftari, kishte ikë Naime Daci, kishte ikë Zyme Belegu, kishte ikë Namik Luci. Këta të gjithë kanë qenë një gjeneratë, një gjeneratë. Natyrisht me ato idealet se Shqipni, po shkojmë në shtetin amë, se kanë me u pritë para dursh, mirëpo, situata ishte krejt e kundërt. Ata natyrisht se pranohen atje, por me një lloj dyshimi, gjoja se kanë ardhë për me, si me thonë, me shiqu situatën e... jo për ideal, jo për ideal. Dhe, mbas një kohe, kur e shohin se çfarë osht' situata atje, natyrisht se ata reagojnë. Edhe Esati, Esat Myftari burgoset dhe denohet për agjitacion edhe propagandë dhetë vjet. Edhe, dhetë vjet i mban në burgjet, në burgun e Shipnisë. Mandej në bisedë me te, ma vonë thotë se në burg ka qenë, në burgjet shqiptare ka qenë koka e Shqipërisë. Ka qenë intelegjenca, njerëz të shkollum që kanë qenë jashtë,

kanë qenë krejt nëpër burgjet shqiptare. Edhe tha për mu ka qenë edhe një përvojë shumë e madhe e kom komunikimi me shumë njerëz.

Ma ka tregu një detal, një detal se në burg osht' taku me një... ose kur ka shku me marrë një libër në bibliotekë më duket, nuk e gjon, ajo bibliotekistja nuk e gjon librin edhe thotë, "Lema emrin, kur të vjen libri unë të paralajmroj, ti prit në sallë". Ai pret në sallë, edhe natyrisht se ka pasë edhe leksusë tjerë aty, edhe thërret "Myftari?" Ky çohet. Kur një plak e çoi kokën në moment, tha, "Unë e morra librin, kur e morra librin erdh m'u afër. Tha 'Myftari, prej nga je ti?' Tha, "Unë jam nga Peja. 'Mos rasisht e ki njëjtë Emrush Myftarin?'" Tha, "Po, une e kom pasë axhë". Tha, "Une jom një shok i Emrushit, me të cilin kem qenë në Francë bashkë. Kem botu..." Ai gazetar kishte qenë, nuk po më kujtohet tash emri. E mandej tha, "E kem kriju një shoqni shumë të mirë edhe shpesh buzë detit shkojshim e bisedojshim, më tregojke për shumë ngjarje". Ma vonë, te dytë kanë ra në burg, "Kështu që edhe në burg shumë gjana i kem asi..."

Mandej kur u bo demokratizimi pak atje në Shipni, kto e lirojnë një dy vjet përpara, e lirojnë prej burgut. Një kohë punon si punëtor krahu, mandej zgjidhet në parlamentin e parë demokratik të Shqipërisë (buzëqeshë). Zgjidhet si deputet parlamenti edhe e shkrun deklaratën e parë për Kosovën, memorandum për Kosovë. E mandej kontaktet i kem pasë edhe ma shpesh, shkojshin në Shipni. Edhe unë... ai kishte pasë takime me shumë... me Petro Markon, Skender Luarasin, me shumë shokë që kishin ba muhabet. I lindi edhe atij idea për me bo diçka, meqenëse edhe Mehmet Shehu ka qenë në Luftën e Spanjës, domethonë jonë njëjtë prej Luftës të Spanjës, jonë njëjtë baba im edhe Mehmet Shehu. I drejtohet me një letër Mehmet Shehut, thotë, "Me bo diçka për Emrushin". Mehmet Shehu i thotë, "Shkruaj ti çka ta merr mendja, ato kujtimet e tuja që i ke ndi prej familjes krejt". Dhe ia dërgon letrën, mirëpo heshtet. Mbetet me aq. Duket, aty ka qenë dora e Enver Hoxhës.

Tash filloj unë me hulumtu. Shkoj në Arkivin e Kosovës, aty e kom pasë edhe një shoqe pejane ka qenë Sulltane Ukaj, ka punu aty [si] historiane. E gjoj përkrahjen e saj shumë për me hulumtu dokumentacione, gjoj mjaft dokumentacione. Mirëpo, më thojnë se ka ekzistuar dosja e Emrushit, të cilën e kanë pasë disa historianë në dorë, mirëpo nuk ka qenë klima e përshtatshme për me shkru për ate. Se hala kanë qenë ato garniturat komuniste që kanë pasë kundërshtimet mes veti edhe mësojnë, më tregojnë për Institutin Albanologjik, njëni... më drejtojnë te ai se ai e ka pasë dosjen. Edhe une shkoj, Bislimi mbiemnin, nuk po më kujtohet emri, më pranon, e thërras me telefon, më pranon, shkoj. Tha, "Dosja e Emrushit ka qenë shumë e madhe. Ka pasë shumë dokumente, fatkeqësisht ne historianët që nuk kem ditë, na i kem marrë veç ato çka na kanë vyjtë neve. Për shembull, për ndoj shkrim ose diçka edhe në vitin '91<sup>1</sup> kur jonë tërheqë serbët, e kanë marrë edhe dosjen me veti. Nuk e kanë lonë ktu, e kanë marrë".

Unë tentoj mandena me i kapë lidhjet me Beograd, me shqiptarë atje që ishin. Një profesor, profesor Petrit... s'po më kujtohet mbiemri, më bjen në mend ndoshta. Ai më thotë, "Të kishte qenë ma heret, kom mujtë me hy në Arkivin e... tash osht' e pamundun se Arkivi Shtetënor ose Ushtarak osht' nën

<sup>1</sup> E intervistuar e ka fjalën për vitin 1999.

mbikqyrjen e Ruisë. Aty s'mundet kërkush me hy". Kështu që, dështon edhe çashtja. Por ato letra pak që kanë ngelë, pak bisedat me njerëz që e kanë njoftë, me qaq pak materiale sa kem mujtë me siguru edhe Esati që ka bisedu atje në Tiranë, botohet monografia në vitin 2011, edhe promovimi bahet në Pejë. Vijnë personalitete prej Shipnisë, ministri i Punëve të Jashtme Alfred Serreqi, vjen një historian Bici, vijnë edhe dy profesorë tjerë, vjen edhe një bashkëluftar Halit Gjuka, i babës që ka qenë. Edhe ai i tregon mandej ato peripetitë që kanë pasë gjatë luftës. Jom, domethonë osht' për mu edhe për vllaun tem, osht' realizu' një andërr që s'paku të mbetet një libër për gjeneratat që vijnë për veprimtarinë e babës.

Edhe në këtë moshën e tretë që jom, domethonë pas penzionimit, e kom gjetë dhe një aktivitet të cilin e kom shumë për zemër. Me bo diçka për fëmijtë e familjeve të varfuna që nuk kanë mbështetje as në familje, që ndoshta edhe në shkollë lihen... jemi një organizatë, punojmë në një organizatë humanitare të cilën e ka themelur një austriake, një Maria Marta në Vitomiricë, aty jom që katër vite, edhe e jepi atë kontributin tem modest. Ndoshta përvojën që e kom gjatë jetës, edhe do ta thom një thanje shumë të bukur të grusë së presidentit Roosevelt, Eleanor Roosevelt e cila thotë, "Kur kemi fillu të mos japim kontribut, kemi filluar ngadalë të vdesim". Domethonë deri sa jemi në gjendje me dhonë diçka, në kontribut nuk duhet me kursy.

Ju falemnderit shumë për kohën që keni gjetë, për kte punë qaq të vyshme që po e bani dhe që po i regjistroni historitë e njerëzve. Nuk osht' kjo veç historia e familjes sime, ka edhe shumë familje tjera që e kanë pësuar ndoshta të njëjten... mos të thom tragjedi, po të njëjten... përvojë gjatë jetës. Prandej, keni çka të boni. Ju lumtë për punën që po e boni.

## Lufta

*[Pjesë e intervistës e prerë nga video: intervistuesja pyet të intervistuarën rreth përvojën së saj në luftën e vitit 1998-99.]*

**Luljeta Myftari Bajri:** Pas gjithë atyne përpjekjeve për rezistencën pa dhunë edhe më duket se kishte ardhë momenti se duhej ba diçka. Edhe pse kjo periudhë kishte sjellë deri te internacionalizimi i çështjes shqiptare në botë. Kishte fillu edhe bota me na njoftë, vjen deri te dalja në skenë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Goditja e parë osht' në vitin 1998 me ekzekutimin e gjithë familjes të Adem Jasharit, mandej fillon edhe lufta kadalëdale të zhvillohet. Kyçen natyrisht edhe shumë të rijë shqiptarë edhe vjen momenti kur lufta merr hov të madh edhe detyrohem, domethonë na përzojnë. Pejë sidomos e përzojnë prej, një... ndoshta ishim edhe pak naivë, nuk na merrke mendja se do të vij deri te ai shkatërrim edhe aq i madh.

Kështu që, unë me bashkëshortin tim nuk dojshim me dalë prej shpisë, une e kisha përgatitë poshtë podrumin edhe kisha me hy në podrum, gjoja se ata nuk mundën edhe me hy në podrum edhe me (e

pakuptim. 1:42). Por, nuk na merrke mendja që ka m'u zhvillu një luftë aq e ashpër. Mirëpo, e pam në momentin e fundit se nuk ishte ma ktu, na hynën policia mrenda. Krej gati përreth kishin ikë, edhe ne bashkohemi për m'u bo bashkë, me familjen ktu afër kojshisë i kishim... (e pakuptim. 2:05). Tubohem aty bashkë, në mëngjes na hyjnë policia, ushtria-policia, disa me maska, disa pa maska, edhe na thojnë, "Nesër në mëngjes me ju gjetë ktu... ju (e pakuptim. 2:25) demek, sa ma parë me ikë". Edhe na ikim, dalim me tri kerre.

Ma heret krejt familja ishim këtu, djalin e vogël e kisha në Prishtinë, Gazmendin. Ai punonte në Zyrën Amerikane atje edhe nuk mujtëm me ardhë. Këtu i kisha kta dy djemtë tjerë, Mentorin edhe Ilirin me familjet e veta, edhe me fëmi të vegjël. Ilirin e merr familja e bashkëshortes tij, shkon se s'kishim vend edhe për me kerr. Atëherë nisem na, bashkë me Mulaqët edhe nisem për me shku m'u nisë kah Rozhaja andej. Kur vijmë në punktin, osht' para se me shku në Rozhajë, ...[e pakuptim.] një vend aty ku ishte punkti i policisë. Një polic e njëf Ademin aty, boshnjak ni polic. Edhe e kishin qitë lajmin se Ademin e kanë vra.

Në atë kohë dy ditë përpara ishte vra Bajram Kelmendi me djemtë e vet, ajo ishte një goditje shumë e randë. Edhe na pritshim, edhe te na ka me ngja diçka. I afrohet ai polici boshnjak edhe i thotë, "Adem, a je i gjallë a?" Tha, "Po, si po sheh, jom gjallë." Tha, "Edhe ka pasë arsye shumë për me pëlcitë edhe zemra prej ktyne çka po shohin, por jom gjallë". Thotë, "Une i kom edhe tri kerre pas meje, të lutem nëse ka mundësi..." se ju merrshin edhe kerret, i qitshin prej kerreve, edhe ai më duket ju boni atyne me shejë edhe na lshunë.

Shkum kah Mali i Zi, e kalum Rozhajën. Rrugës delshin malazezet, na gjujshin me gurë, njena me bukë. Ia thej shofershajbën [xhami i përparëm i veturës] këtij kojshisë. Nejse, shkum në Ulqin. Në Ulqin ishte mbledhë gati prej Kosovës tona anët. Në Ulqin, atmosfera ishte shumë e randë. Më pengojke shumë se gratë menihere e gjejshin, u adaptunë menihere, thirrshin njona-tjetrën nëpër çajna, nëpër kafe me bo biseda kështu. Shumë më pengojke, më vijke shumë randë. M'u duke shumë e randë diçka me shku me pi kafe, me bo biseda.

E kishim... Iliri ishte njoftu me, në vitin '97 ose '96 me Vanessa Redgrave edhe ajo kishte ardhë ktu në Pejë. Do të thotë Iliri kishte ardhë natyrisht me pa situata qysh osht', me marrë informacione. Se ajo, ka qenë ambasadore e Vullnetit të Mirë, a diçka ka qenë në Kombet e Bashkume. Edhe takohet me Ilirin, edhe më thotë Iliri, "Mamë a ta thrrasim një ditë në mëngjes?" "Po more, thirre!" Thashë. E thërrasim këtu në mëngjes edhe ajo merr informata, e bisedojmë. Me na u gjindë Vanessa, me marrë vesh ku jemi na, me na i përgatitë krejt dokumentat, e me na marrë në Itali. Me dalë në Itali me na pritë tre deputetë e parlamentit italian, Vincenzo Siniscalchi, gruaja e vet avokate nuk di si e ka pasë emrin. Dalin me na pritë në Bari.

Na shkojmë me anije Bari-Bari. Shkojmë në Itali. Në Itali na vendosin me një qendër për refugjatë edhe na presin shumë mirë në lagjen Marechiara ajo pjesa ma e bukur e Napolit. Në Napoli shkojmë, në Napoli vijshin me na vizitu personalitete të ndryshme... Ademin e intervistojnë, vijnë shumë gazetarë e intervistojnë për me marrë informata për situatën të cilën... bile e kom diku edhe artikullin që osht'

shkru atje në një gazetë italiane. Iliri gjithmonë e ka deshtë muzikën, domethonë tre djemtë tonë edhe pse une e bashkëshorti kemi qenë jurista, ata nuk i kem shti, i kem lonë të lirë me zgjedhë çfarë profesioni dojnë ata, kështu që tanë kanë shku kah kultura. Iliri me muzikë, Mentori me muzikë, Gazmendi si kameraman, e qashtu.

Edhe Iliri, Vanessa kishte ndigju ktu Ilirin t'u ekzekutu në piano edhe i kishte pëlqy shumë, i ka pëlqy shumë. Edhe duket i ka përcjellë edhe atyne që osht' pianist. S'ka kalu as një javë po më duket, ia kanë pru pianon në atë qendër Ilirit me ekzekutu në piano, me ushtru domethonë. Edhe e thërrasin Mia Pia Fanfani, gruja e atij presidentit italian Fanfani<sup>2</sup> e cila ishte në atë shoqatën Acrobaleno italiane, një shoqatë për ndihma humanitare që i kish ndihmu edhe Kosovës. Merr vesh, ia organizojnë Ilirit një koncert humanitar në një kishë shumë të vjetër në Napoli, Santa Chiara një kishë shumë e bukur. Me ekzokutu edhe me mbledhë donacionet për me iu ndihmu ktyne shqiptarëve që ishin, gjindeshin në kampin e Maqedonisë Stankovec ose ky kampi tjetër që ka qenë. U ba një koncert i mrekullushëm, më dhimet shumë që nuk osht inçizu, po i kom disa fotografia prej koncertit. 45 minuta ekzekuton me piano, aty ka qenë ajka e Napolit. Edhe jepen donacione, mledhen ato donacione për atje. Mandej i mban edhe nja dy koncerte, nja dy koncerte aty në Napoli, natyrisht humanitare.

Vjen koha për me u kthy, tre mujë e gjysë kem ndejtë në Napoli. Kah fundi ia nisëm me u mërzitë, Mentori me famlije s'na mirrke mendja që ka me u kry shumë shpejtë, bombardimet vazhdojshin hala. Mentori e merr familjen edhe niset për Gjermani. Aty mbesim na me Ilirin edhe vjehrra ime, Ademi, mbesim në Napoli. Por, kthehem edhe na kthehem. Kur vijmë, shpija shkrum e bame. Krejt kto shpijat përreth kanë qenë të kalluna plotësisht, duhej fillu krejt nga e para. Nuk më dhimej qaq shpija, isha e lumtur që s'pari kishim shpëtu, kishin shpëtu fmitë dhe kishim shpëtu si familje. Nuk më kishte pësu as fëmitë e vllaut se ata ishin jashtë edhe gruja e vllaut ishte në Sarajevë.

Shpija e vllaut atje ishte rrafsh me tokë. Nuk m'u ka dhimtë qaq shpija, sa m'u ka dhimtë që na u kanë djegë të gjitha kujtimet. Fatmirësisht, Mentori i kishte mbledhë disa albume, i kishte shti me një thes të najllonit. Ishte shku në podrum, nën qymyr i kishte mshefë. Edhe ato kishin shpëtu, mirëpo na ishte kallë një bibliotekë me pesë-gjashtë mijë libra. Libra shumë të vjetra që kishin mbetë edhe prej bilbotekës të babës. Natyrisht edhe te vllau ishte kallë. Në bibliotekën e babës kem pasë edhe librin e Pjetër Budit, i cili i botum në vitin 1663, ndër librat e para të shkrome në gjuhën shqipe. Edhe ai libër ishte kallë.

Mirëpo, edhe diçka një detal du me iu tregu, jam e lumtun që prej të gjithë atyne librave që kishin ngelë, mbasi e kishin marrë bibliotekën, përkthimet në gjuhën shqipe prej Fan Nolit, prej ktij Faik Konicës, prej tjerëve, daja im Hasan Mekuli ishte ardhë i kishte mbledhë dhe mandej ato jonë ribotu. Ajo e mira që jonë ribotu, domethonë nuk kanë shku poshtë ato libra.

---

<sup>2</sup> Fanfani ishte kryeministër i Italisë dhe president i Asamblesë Gjenerale të Kombeve të Bashkuara.

## Ëndrrat

*[Pjesë e intervistës e prerë nga video: intervistuesja pyet të intervistuarën rreth ëndrrave dhe dëshirave të saj]*

**Luljeta Myftari Bajri:** Natyrisht se njeriu gjatë jetës ka andrra. S'osht e thonun që ato andrra do të realizohen, mirëpo duhet përpitur që s'paku t'i realizosh. Ndoshta andrra ime e posaqme ka qenë meqë isha rritur pa prindë, edhe pse nuk mund të ankojem se kta prindë që na kanë rritë kanë qenë shumë të mirë edhe na kanë përkushtu të gjithë dashurinë edhe kujdesin. Po sidoqoftë, andrra ime ka qenë që të shkollohem edhe të krijoj një personalitet timin, të jem një person i fortë që mund t'i përballoj të gjitha sfidat me të cilat duhet të ballafaqohesh në jetë. Jam e lumtun që sado pak kom kriju një familje mund të thom të shnohtë. Që jam e knaqur me tre djemë të cilët e vazhdojnë jetën e tyne, kanë familjet e tyne edhe ata mundohen me i realizu andrrat e tyne.